plot me māll mbë të dhifisur,
gjith gëzonej sā t' e shihëj
aqë e bukur. Kurmi i hōllë,
si purtek e rgjëndë i helqur,
kish mẽ ḥē se këmba e shegës
ç' i lulzonej ndë mes kopshtit.
Po kush ish ç' i glisj së bijës,
kush nkā Arbreshezit, çë janë
mẽ të bukurat te jeta ?
Kript e blērshëm i kish sillën
e të parës rrëmp e diellit
mbi një raḥ ku përflushur arash;
dukej ār te kriethit pleksur,
ār të tjerrë e vënë pāḷ.
Vollīt ishën trundafile
çë menatnet zẽn e hapen,
puḥīs vesme e paraverës,
ndër të bardhëza e të kuqe.
Sīt jothije ndër të kālthër;
i kallzojën shpīrt i thiellm.
Bujuresha prān llojasi:
– «Dielli shpīn me drit gëzon,

δ 1 qindisëj‖ qindis'j 5 presjën‖ p'resjën 9 qepëj‖ qep'j 12 shihëj‖ shih'j 17 glisj‖ glis'j

IV

La figlia di Jorga, ricamando
una splendida veste,
non cantava a bassa voce,
né la gioia le folgorava dagli occhi,
come alle fanciulle che attendono
una festa per adornarsi.
La signora madre le sedea vicina,
intenta a far l'orlo ad un candido velo;
anch'essa cuciva in silenzio,
ma alla figlia talvolta
rivolgendo amorosa lo sguardo,
gioiva nel vederla
tanto bella. Il corpo esile,
slanciato come argentea verga,
avea più decoro del melagrano
che fiorivale in mezzo al giardino.
Or chi somigliava la figlia sua,
chi tra le Albanesi, che sono
le più belle della terra ?
La chioma bionda avea il fulgore
del primo raggio di sole
sopra un colle fischiante di spighe;
pareva oro intrecciato sul capo,
oro filato e messo a mucchio.
Le guance erano rose
che in sul mattino si aprono,
all'aura rugiadosa di primavera,
tra candide e vermiglie.
Gli occhi di viola, nuotanti in luce azzurra,
rivelavano un'anima purissima.
Pensò poi la nobile matrona:
– «Il sole mi allegra col suo lume la casa,

si mẽ parë; po jo vajza
me këndime; nani rrī
si fëllëza te foleja.
Mos ndo trim i rī m' e puthi ?
O petrit, petrit i pār,
ktë fëllëzë eja e rrëmbe;
rrëmbee e sīlle bashk me tīj,
e të di të lum trazhgofshit !»

V

Si nkā punët të lëshuame,
te diert ujur, flisjën vashat,
afr të jëmavet çë tīrjën,
të pā-lothta; mbrëma rrusej,
me të gjera ḥe, nkā mali
prapa çilit humbi dielli.
Mbi të lartën çuk e Pelravet,
feksmit ajr çë ndihej mbrazët,
īllthi i pār shkëlqej i vetmith.
Prān kūr diert gjith u mbīlltin
e mẽ vërashit ngë shihej
drit as vatrash as hërnarësh,
e flẽj hora përposh hënxës,
çë te qielli i humbët dhizej;
bija e Jorgës, gjum tue zënë,
gjegji zërin i të dashurit.
I karceu te gjiri zëmbra,
u pataks e mori vesh.
– «Si qithere nkā foleja,
more e bukur, ti harapsu
të m' gëzosh me gazin tënt,
të më dësh me zẽthin ëmbël.
Të fton jeta; zbīll e ruaje.
Ḥeth mbi bārthin e mbi lulet,

δ 17 zëmbra]] zëmb'ra 33 dritsoren]] drit'soren

come prima; ma non la vergine
con le sue canzoni; ora essa sta
quasi pernice dentro il nido.
Che me l'abbia baciata qualche giovine ?
O sparviero, primo in tra gli sparvieri,
questa pernice vieni a rapire;
rapiscila e teco la porta lontano,
e insieme godiate la vita beati !»

V

Mentre sciolte dalle fatiche,
sedute alla porta, conversavano le fanciulle,
presso le madri intente a filare,
instancabili; scendea la notte
con larghe ombre dal monte
dietro il quale era tramontato il sole.
Sulla cima superba di Pelas,
all'aria diafana che si sentia vuota,
solitaria splendea la prima stella.
Poi quando furono chiuse tutte le porte,
e dalle fessure più non vedeasi
chiarore di focolari né di lucerne,
e il paese dormia sotto la luna,
che ardeva nel cielo profondo;
la figlia di Jorga, in sull'addormentarsi,
udì la voce del suo diletto.
Le balzò il cuore nel seno,
si levò e stette ad ascoltare.
– «Come tortorella dal nido,
o mia bella, ti affaccia
ad allietarmi col tuo sorriso,
a inebriarmi con la tua voce soave.
T'invita l'universo; apri la finestra e miralo.
Piove sull'erba e sui fiori,

edhe ato si të qëlluame,
rrëmpën hënxa e ves ndërronet.
Me kriet fshehurith nën xhethevet,
nd'ëndërr zogazit këndojën;
dridhet mālli trundafilja
si ferrakuthi, mbi degën,
i ḷëngonet e e lëvdon...
Ti çë bën në gjegje mua ?
Hap dritsoren e dëftomu,
m' u dëfto sā e bukur jē,
motr e hënxës, zonjëz'oo».

VI

– «Sā shkëndijën bukur izë
tek i buti qiellthi jinë !
u, si nj' īll çë kërkon njetër,
jam e vete gjēnj atë
çë te nata më thërret
ndër lulzuamezit fitī.
Trimi i dashur ẽ mẽ i bukur
se gjith tjerët çë ju njihni,
bija t' zotravet shqiptarë.
U nani ju truhem gjithve
mos zilisni mua t' fanmīren».
– «Isht e humbët nata e e qetme;
po si rrëmp i rgjëndë e hënxës,
vjen ajo ç' ẽ ḥujthi jim.
Ngrëhen lulet mbi kalliun,
si m' e ndiejën, se deshīrjën
të jën mbjedhur nkā ajo dorë,
nkā ajo dorëzë aqë e bardhë,
e të veshken mbi atë gjī.
Psë ngë jam një trundafile ?
E përitur, si notia
ẽ nkā bāri ç'isht e veshket,

δ V 33 dritsoren‖ drit'soren 35 motr‖ mot'r

che anch'essi sembrano addormentati,
la luna il suo mite che mutasi in rugiada.
Con la testina ascosa tra le ali,
pigolano gli uccelletti sognando;
trema d'amore la rosa,
mentre il rosignolo, sopra un ramo,
le si raccomanda e la loda...
Tu che cosa fai se mi ascolti?
Apri la finestra e mi ti mostra,
mi ti mostra in tutta la tua bellezza,
o sorella della luna, o mia signora».

VI

– «Quanti vaghi astri scintillano
nel nostro cielo mite !
Io, come una stella che ne cerca un'altra,
vado a trovare colui
che nella notte mi chiama
tra le piante in fiore.
Il giovine amato è il più bello
di quanti altri voi conoscete,
o figlie dei nobili Albanesi.
Or io a voi tutte mi raccomando
che non invidiate la mia felicità».
– «È profonda e silenziosa la notte;
ma come argenteo raggio di luna,
viene colei che è l'idolo mio.
Rizzansi i fiori in sullo stelo
appena la presentono, ché desiderano
d'esser colti da quella mano,
da quella candida manina,
e di languire su quel seno.
Perché non sono io dunque una rosa ?
Attesa, come la rugiada
dall'erbetta che langue,

ti m'arrẽn, o gjith e mirë.
E pa-njohurë, nat e dit,
të kërkova gjithasājtanith;
rreth gjith-qish për tīj më flisjën:
qielli i kalthër, dheu me lule…
Po të deja e ti ng' e dije,
se një ninë e trūvet ishe,
ninë e ḷē, pā-shtat, flurore.
Ni çë t' gjeta, ti jē jimja.
Jē gjith jimja ti, o Haidhī,
ktu kumbisu, të të thom
sā të dua… Trī herë i lum
kush përkrahu tīj isht ujur !
Shpīrti jim, për ëmbëlī,
si livan te zjarri, ḷoseᵭ».
– «Të të gjegjem, gluh-e mjāḷt,
ndë gjī zëmbra më karcen;
po ngë dī përse kshtu dridhem
te gjith kurmi, si purtek.
Deja t' isha edhe të mos t'isha,
më ktë herë, ktu me tīj;
po aqë hīr i kam t' i jēm,
sā dēj' kisha māll, në ng'isha.

δ VI25 gjithasājtanith;‖ gjith asājtanith; 26 gjith-qish‖ gjith qish flisjën:‖ fllisiën:

tu a me vieni, o tutta buona.
Senza che ti conoscessi, notte e dì,
io ti cercai per ogni dove.
Tutto intorno di te parlavami:
il cielo azzurro, le terra con fiori...
Ma t'amavo e tu non lo sapevi,
perché eri un'immagine della mia mente,
immagine lieve, incorporea, vaneggiante.
Or che ti ho trovata, tu sei mia,
sei tutta mia, o Haidhee.
Qui t'assidi, ché ti dica
quanto t'amo... Tre volte beato
colui che ti siede vicino !
L'anima mia, per tanta dolcezza,
come incenso al fuoco, si strugge».
– «Ad ascoltare te, dal soave eloquio,
mi balza il cuore nel seno;
ma non so perché mai io tremi così
per tutto il corpo, quale verghetta.
Vorrei essere e non essere
qui teco a quest'ora;
però d'esserci ho tanto piacere
quanto ne avrei avuto desiderio se non ci fossi.

VII

Vajza bẽ një bukur ëndërr.
Si gjith shokezit e ḥeshme
edhe bridhjën për ndë sheshit,
ajo prëhej nën njīj kumbullje,
aqë e plot të bardhash lule,
skūrse u ḥoth mbi degët bora.
Me një gas trimi i përdashur
ju faneps, e kish te shtāti
ḥēn e madhe e farës tīj.
– «Kā ca mot çë ngë përpiqemi,
se te shpia nani ti rrī,
si edhe nuseza te siu.
Të kam pritur ndita ndita
u te kroi sa t' të flisja;
īll menatje të të thoshja,
lil i vetmith ndë përrua,
jothī e fshehurzë nën bārit...
Të kam pritur po s' kē jardhur».
– «Po ndë shpī, t' e dīsh, u rrī,
mos më marnjë fixhën dielli,
sīvet tat mos bier gjẽ shiḷe;
me tīj-vo ngë dua jēm pār
mos më shanjë gjindja e ligë...»
– «Lēi të thēn! Ç'e duam na gjinden ?»
Prān për dorje e mori e e holqi
tek i larti stēr i prindit,
zonjës motër e pā-martuame;
ç'ish e bëj tek argalia.

δ 13 pritur‖ p'ritur 14 sa t'‖ sat' 18 pritur‖ p'ritur 27 motër‖ mot'r

VII

Ebbe la vergine un bel sogno.
Mentre tutte le sue vaghe compagne
sollazzavansi ancora per la pianura,
ella si riposava sotto un susino,
così pieno di bianchi fiorellini,
che i rami pareano carichi di recente neve.
Con un sorriso, il giovine amato
le apparve, e avea nell'aspetto
tutto il decoro della sua famiglia.
– «Da qualche tempo non c'incontriamo
ché ora tu stai a casa,
come la pupilla in mezzo all'occhio.
Ti ho aspettata di giorno in giorno
alla fontana, per parlarti;
per dirti astro mattutino,
giglio solitario in una valle,
violetta ascosa in mezzo all'erba…
Ti ho aspettata e non sei venuta».
– «Ma sappi che io sto a casa
perché il sole non imbruni il mio viso,
e io non perda avvenenza agli occhi tuoi;
poi non voglio esser teco veduta,
perché non mi biasimi la gente trista…»
– «Lasciale dire! Che c'importa della gente?»
Poi la prese per mano e la trasse
dentro il superbo castello paterno,
alla signora sorella non maritata,
intenta a lavorare al telaio.

VIII

Natën e të Shtunies madhe
nkā dritsoret e nkā diert,
të përhapura harës,
ḥidhej mb' udhë drit hërnarësh.
Vejën vashat për ndë horës
tue kënduar, si isht zakonë;
e me ato ish edhe Haidhia.
– Mbi të mbrastin varr i Krishtit
nes menat dëftonet nj' ëngjëll
i shkëlqiem si diell mjesditje,
e gjith jeta, e nxjerrë lipit,
do kumborvet të gëzonet.
Pati fān si in Zot Shqipria.
Ndë druetī, tek ai vit,
shkojën Kreshmët; jo për Krishtin;
se të ngjāllet vdes i lumi;
po për trimat, gjith bij zonjash,
fshehur Divër, ndë mes shpatvet.
Duan të priren me aqë fōrë
si m' u nisën, sā të bëjën
bashk të krëmtezit e Pashkvet
me të motrat e të jëmat
e me prindrat, çë ngë vdiqën
tue luftuar përpara shpīvet ?
Rān mbi t' huajit si shkaptima,
e nkā Turqit pak e pān
atë e Diellzë të ngrisej.
Po me mbretin i lëvduam
Krojë u pruartin gjith Shqiptarët;
si me Shejtrat, te Parrajsi,

δ 2 dritsoret‖ drit'soret shpatvet 6 zakone‖ xakone 19 priren‖ p'rirrn 18 shpatvet.‖

VIII

La notte del Sabato grande
per le finestre e per le porte
spalancate alla gioia,
spandeasi sulla via il chiarore dei lumi.
Percorreano il paese le vergini,
cantando, secondo i costumi;
ed era con loro anche Haidhee.
– Sul vuoto sepolcro di Cristo
domani apparirà un angelo
splendido come sole meridiano;
e il mondo, smesso il lutto,
si allegrerà al suono delle campane.
Simile a quello di Dio fu il fato d'Albania.
Nell'angoscia, in quell'anno,
passava la Quaresima. Non per Cristo;
ché per rivivere muore il fortunato;
ma per gli eroi, tutti figli di matrone,
nascosti nella Dibra, tra le selve.
Torneranno essi, così pieni di baldanza,
come partirono, a celebrare
le feste della Pasqua
con le sorelle e con le madri
e coi padri, non morti
combattendo davanti alle proprie case ?
Sui nemici piombarono come folgori,
e pochi dei Turchi videro
tramontare quella domenica.
Ma col re glorioso
tornarono a Croja tutti gli Albanesi:
come in cielo, coi santi,

kā të priret Perëndia,
çë te jeta mundi vdekjen.
U m'u qasa e thash Haidhīs:
– «Nes te valla, zëmbra jime,
vuru nd' ānxë sime motrje;
se kūr vinj asāj nkā rrollja,
të më fshinjë djerst e ballit,
tīj dua shoh, se siuthi jit
mua tek eshtrat rrin fuqīn.
E ti qeshëm; ẽ mẽ mirë
ime motr t'e die se duhemi».

δ 37 djerst][] djers't 41 motr][] mot'r

tornerà il Signore,
che nel mondo ha vinto la morte.
Io mi appressai e dissi a Haidhee:
– «Domani alla ridda, o cuor mio,
sta vicino a mia sorella;
ché venendo a lei dal disco,
perché ella terga il sudore dalla fronte;
io voglio veder te. L'occhio tuo
mi accresce il vigore nelle ossa.
E tu sorridimi; è meglio
che anche mia sorella sappia che ci amiamo».

IX

– «Jiku gjumi nkā sīt tim,
po edhe nata isht e humbët.
T' isha vetëm te kī dhē,
me atë vajzë çë dua mirë !
F. fjantaks ujur të ḥēshmen
nën të gjërës parghuḷē,
njīj e bardhje shpī përpara,
zbjerrë te një fush e gjelbër,
nkāha shihet tutje dējti.
Ajo, linjëzën tue qepur,
këndon kënkat ç'i kam bẽr,
e një djalëth, lule e māllit,
çë te sīt kā dritën time,
shtūr mbi barin, gjimsa xheshur,
nd' ānxë i breth me një languar.
Prān vërrën, me dashurī,
vreshtën tënë, thūrur drizash,
sā mos dhelprazit t' i hinjën,
e, mbë gas, më sheh si vete
tue shpërfletur dhrīt një e një,
të më shunget aguridhja.
E vërtet t' ish ëndërra jime !
Ahër drekeshim mbë derë,
mbi një gūr i math si tries;
u i harepsurith i flisja
e të korrash e të vjelash.
Prān si dielli dalë e dalë
brënda dējtit humpëj i kuq,
u të bukurën mbi glunjët
mirrja; e puthja të vollīzit,
e i shakmisja kripthit āri».

δ 22 ëndrra‖ ënd'rra 28 humpëj‖ hump'j 29 kukurën‖ bukrrën

IX

– «Fuggì il sonno dagli occhi miei,
ma la notte è ancora profonda.
Fossi solo in questo mondo
con la fanciulla che amo !
Io me la figuro seduta quella vaga
sotto il vasto pergolato,
davanti a una bianca casa,
perduta in una pianura verdeggiante,
donde si vede il mare lontano.
Ella, cucendo una camicia,
canta le canzoni che per lei composi;
e un bambino, fior dell'amore,
che ha negli occhi la mia luce,
steso sull'erba e seminudo,
le gioca vicino con un levriero.
Poi essa guarda, con affetto,
la nostra vigna, tutta ricinta di rovi,
perché non v'entrino le piccole volpi,
e, dolce sorridendo, me vede intento
a sfrondare le viti ad una ad una,
perché maturi l'uva agreste.
Oh fosse una realtà il mio sogno !
Allora pranzeremmo alla porta,
sovra una pietra larga come una mensa;
e lieto io le parlerei
della mietitura e della vendemmia.
Poi mentre il sole lentamente
scenderebbe rosso dentro il mare,
io la mia bella sui ginocchi
mi torrei; la bacerei in viso,
scomponendole i capelli d'oro».

X

Tek e bardha dit e Pashkvet,
vit për vit aqë e përitur,
vetëm plaku, që ngë leu
ndër kta male, kā helm e lip.
Valla vete për ndë horës,
e hareja nkā ngā zëmbër,
si edhe drita nkā t' më-t'-errtit,
shkrepet grikshit me kangjele.
Ujur afër Kroit e rī,
shumë i vrërët, si na duket
çuka e Pelravet te dimbri;
Dodha, i sprasmi ç'edhe rron
te të shkluamit shok t' Iskandrit,
(embri i cilit pā-i-harruam
e gjith-monë kloft i ndērm),
rrī e vërrën, tue klār si dhrī.
– «O bulerë, o shokt e mī,
thot ai, pse bashk me jū
ngë jam u ? Si lis i moçëm
nkā shkaptimat i shpërfletur,
u qëndrova plak e i vetëm,
se ju prëhij gjith te varri,
gjith te varri i dheuthit tënë.
Kūr nani kta bij u shoh,
zëmbrën time e zẽ mëria;
thom se ktu, te i huaji dhē,
bijt e tire, pak e pak,
duan harrojën gluhën tënë,
edhe vendin ku flẽn Gjishrat...
O bujarë, o shok e mī,
pse ngë jam u bashk me jū ?

δ 4 male ‖ mal' 17 e mī‖ ēmī 30 e mī‖ ēmī 31 jū ?‖ jū !

X

Nel bianco giorno di Pasqua,
tanto atteso ad ogni anno,
solo il vecchio, che non nacque
fra questi monti, ha dolore e lutto.
La ridda percorse il paese,
e la gioia da ogni cuore,
come la luce dalle tenebre,
erompe per le bocche in liete canzoni.
Seduto presso alla fontana nuova
assai fosco, quale a noi sembra
la cima di Pelas nell'inverno,
Dodha, l'ultimo che viva
dei nobili compagni d'Iskander,
(il cui nome vinca l'oblio
e in ogni tempo sia onorato)
sta a guardare, e piange come vite.
– «O duci, o miei compagni,
dice egli, perché con voi
io non sono ? Come quercia antica,
sfrondata dalle folgori,
son rimasto vecchio e solo,
poiché voi tutti riposate nel sepolcro,
tutti nel sepolcro della nostra terra.
Or nel vedere questi figli,
il mio cuore è preso dalla mestizia.
Forse qui, nell'estraneo suolo,
i loro discendenti, a poco a poco,
dimenticheranno la nostra lingua,
e il luogo dove gli avi dormono…
O duci, o miei compagni,
perché non sono io dunque con voi ?

Në se atej pamet, ndo herë,
nkā na jerdhëm, kini t' pririj,
mos harromni ktu, o Shqiptarë;
po nkā e rënda bot litire
eshtrat tim, si ata t' Gjërīs,
edhe nxīrni, e me të ftohtit
ujë t' Varfërit m' i lāni
edhe prān me verë e vjetër,
me të bardhën verë e Llāzit,
e m' i sīllni bashk, t' i vëni
te ajo klish ku vllezërit kam,
prindit afr edhe mëmës time.
O m' i digjni e shprishni prān
hirin erës, të m' e qellnjë
mbi ata mal' e mbi ata reḥe,
mbi ato fusha plot me lule,
te ku u ndērta e ku trazhgova».

δ 42 vllezërit]] vllez'rit

Se là di nuovo, un giorno,
donde siam venuti, voi tornerete,
qui non dimenticatemi, o Albanesi;
ma dalla grave terra latina
le ossa mie, come quelle dei consanguinei
togliete anche, e con la fredda
acqua del Varfar lavatele,
e poi con vino vecchio,
col bianco vino del Lasi,
e con voi recatele, per deporle
in quel tempio, dove ho i miei fratelli,
presso il padre e la madre mia.
Ovvero bruciatele e spargete poi
la cenere al vento, ché me la porti
su quelle montagne, sopra quei colli,
su quelle pianure piene di fiori,
dove mi resi illustre, dove fui felice».

XI

Të m' i faleshin u qasën
vashat gjith të mjerit plak,
e si qielli pas rrëpirës,
kūr dhe dridhet nd' ajr notia,
rrëmpës diellit pā-kujtim,
ajo fixhë e vrërët helmit,
bukurīs e rē përpara
shpejt u zbut, e sīt përlotur
ndriti gazi i trimërīs.
– «Zoti Dodhë», mori e i tha
e dëḷirëza Haidhī,
«mot e monë ti na rruashe,
ndēr e horës, po rrëfiena
ndo gjagjë të motit shkuam;
se dī shumë ti e pëlqejën
fjalët tote e ngasjën zëmbrën».
– «More e mjāḷta bijë e Jorgës,
si e menatës drita e thjellme»,
zuri plaku, «ndër kopilet
të Shqiprīs çë njoha vet,
u nani jam e kujtonj,
(mos i paçit fān !) Donikën,
beja e madhe e prindit kluam,
zoti Llambër i Ḥimarrës.
Ng' ish kopile te gjith Arbri
çë kish ḥēn e asāj të mirje.
I ḷëngoneshin disā
bij bujarësh; po mosnjerin
ajo deshi; se te zëmbra
kish po Bozdarin lesh-t'-ārtin.
Ngā menat, te mesha e parë,

δ 27 disā][] di-sā

XI

Si appressano a salutare
il povero vecchio tutte le fanciulle,
e come il cielo dopo una burrasca,
mentre ancora tremola nell'aria la rugiada,
al raggio del sole non ricordevole;
quel viso turbato dal dolore,
davanti alla fresca beltà,
tosto serenossi e gli occhi, ancor bagnati lacrime,
illuminò il sorriso della giovinezza.
– «O signor Doda», prese a dire,
la ingenua Haidhee,
«Tu ci viva per lungo tempo,
onore del paese; ma deh ! narraci
qualche istoria degli antichi tempi,
ché tu ne sai molte, e arrecano diletto
le tue parole e ci commuovono».
– «O dolcissima figlia di Jorga,
o pura come la luce mattutina»,
incominciò il vecchio, «tra le vergini
della Sqiperia, da me conosciute,
io ora ricordo,
(non ne abbiate il fato!) Donika,
il giuramento grande del nobile padre,
il signor Lambro della Chimera.
Non v'era fanciulla in tutta l'Albania
che avesse le grazie di quella buona.
La corteggiavano molti
figli di bugliari, ma nessuno di loro
ella volle; ché nel cuore
avea Bosdare dalle auree chiome.
Ogni mattina, alla prima messa,

ata shiheshin te klisha,
edhe u dhezën pā ndëlguar;
se hīn sīshit, pā-i-përitur,
mālli e prān te zëmbra vete,
e atje rritet e shtie rrenjë.
Një dit mori e, me gjith vjershin,
djali i shkruajti një lipush,
t' i kallzoj të madhin māll.
Dërgoi prān e e lipi nuse.
Deshi e jëma, po ngë deshi
zoti i jat, se m' e kish taksur
njīj i huaji i dheut litī.
Dit e nat tue klār m' i shkojën;
e më losej si qërī
vajza e mjerëzë; e te gjiri
i së jëmës herë e herë,
si të dia, tue qepur pajën,
ishën vetëm, mbitur lotshit,
fixhën fshihëj, e, ndë të shëmbur,
– «Mëme», i thosh', «o mëma jime,
pse më pate edhe m' ushqejte
nani t' isha kshtu e pā-fān ?
Ō të vdisja ! e mē mirë ish
se të vete e huaj te i hoi,
ndë mes gjindes çë ngë njoh,
çë ngë njoh e ngë ndëlgonj;
tutje ndeje, si një flet
ç' era shkul nkā dega e sāj.
Ō të vdisja !...» – «Mos e thuaj»;
një hēr zonja ju përgjeq;
«mos nëm ditën çë m' u leve;
se mē i madhi helm ē vdekja.
Tutje meje e shpīs ku u rrite,
ti një mëmë gjēn e rē,
e me māllin i atīj zoti,

8 49 lotshit,]] lot'shit,

essi vedeansi in chiesa,
e si amarono, senza pure accorgersene;
ché penetra per gli occhi inaspettato
l'amore, e poi scende al cuore
e là cresce e mette radici.
Un dì prese e, con bel garbo,
il giovinetto le scrisse una lettera
per manifestarle l'immenso affetto.
Poi mandò a chiederla in isposa.
Volle la madre, ma non volle
l'altero padre, ché l'avea promessa
ad uno straniero della terra latina.
I giorni e le notti le trascorreano in pianto;
e si struggeva come candela
la povera fanciulla; e nel grembo
della madre talvolta,
mentre a cucire il corredo
erano sole, soffocata dalle lacrime,
nascondea il volto, e singhiozzando,
– «Mamma», le dicea, «o mamma,
perché mi partoristi e m'allevasti
a sventura così grande ?
Oh potessi morire! e sarebbe meglio
anzi che andarmene straniera in estranea terra,
in mezzo ad una gente che non conosco,
che non conosco, e non intendo;
lontana da te, come foglia
che il vento strappa dal suo ramo.
Oh potessi morire !...» – «Non dirlo più»;
le rispose, una volta, la matrona;
«non maledire il giorno in cui mi nascesti;
ché la morte è il peggiore dei mali.
Lontana da me e dalla casa ove mi sei cresciuta,
tu troverai una nuova madre,
e con l'amore di colui

çë të do sā sīt, sā gjella,
si edhe e qiellit llumbardha,
ndër gjith tjerat thuhe e lume;
mē se mē kūr bij' të kēsh.
Mosgjakun harē mē e madhe
isht, u thom, se te ajo shpī,
mbë çë vënt te jeta u ndothshit,
te ku duhen burri e gruaja
si te t' vegjëjit përtrihen.
Vet e mjera, ktu ku m' sheh,
zëmbra jime, dua të veshkem
si fitīzë e pā kujdesur,
po ndë lot e sherëtime».
Kshtu tha zonja e kshtu mē shumë
shqori zëmbrën së meruames.
Te një e dielljë, t' e gjēj
vate Bozdari. Ish e vetme
vajza e krihej, tue kënduar
kënk çë dukej një vajtim.
– «Eja e vemi; në m' do mirë,
jik me mua. Si sos le t' sosnjë !»
Hī-fitūr ajo u pataks,
e ngë foli e rreth ng' u rua.
Mbi një kāl i shpejt e i mbrimur,
për ndë sheshevet u shtūn.
Po i përpoqi qeni i huaj
e te krahzit atë trim
më llavosi. Rā nkā kali,
bashk të bukurën tue helqur.
Tek ai vent të di i pështruan,
ku edhe ndodhen njēr' më sot,
nën një bukur trundafile,
t' ishën bashk te bota e zezë,
në ngë klenë te kjo jet.

che ti ama quanto gli occhi, quanto la vita,
come la colomba del cielo,
tra le altre ti dirai beata;
tanto più quando avrai figli.
In alcun luogo gioia più grande
non v'è, ti dico, che in quella casa,
ovunque sia posta al mondo,
dove si amano il marito e la moglie,
rinnovellandosi nei loro piccoli.
Io misera qui, dove mi vedi,
anima mia, verrò meno,
come pianticella abbandonata,
sempre in lacrime ed in sospiri».
Così ella disse e così più ancora
squarciò il cuore di quella mesta.
Una domenica a trovarla
andò Bosdare. Era sola
la vergine e si ravvivava i capelli, cantando
una canzone che parea funerea.
– «Vieni; se mi ami,
fuggi meco. Avvenga che può !»
Pallida levossi ella,
e non disse verbo, e non si guardò intorno.
Sopra un cavallo velocissimo e focoso
gittaronsi per gli aperti campi.
Ma li incontrò lo straniero cane
e quel giovane alle spalle
ferì. Cadde da cavallo,
traendo seco la bella.
In quel luogo medesimo li seppellirono,
dove fino ad oggi si trovano,
all'ombra di un bel rosaio;
perché fossero insieme nella terra nera,
se non lo furono in questo mondo».

XII

Dridhej nj' ill te i rrimti qiell
kūr na prireshim mbë shpī;
e ime motër më zū dorën
e më tha, me t' ëmblin zēth,
tue vërrējtur përs aposhta:
– «Me sā ḥē do t' ngrëhet hënxa,
edhe pak, nga Gropa e mollës !
Bardhësirës sāj do rgjēnden
të mbëdhāt kështenja ç' errjën
ktje mbi reḥet të nën-ērmit
të Drangorës e të Llāzit.
Po gëzim e lumja kā
të quronjë bukurīn
te lumenjezit e thiellm,
se njī herje e pasqirisur
gjithasājtanith e sheh.
Si edhe jeta, o vllauthi jim,
kūr dëftonet zonja e natës,
drit na paçit e harē
shpīza e bardhë, ashtu si hīn
nusja jote, pa-ngār prakun».
– «Po ti, Rinë, o motra e vetme,
jē hareja e silla jonë.
Kā for' mëma të të kēt,
e kā prindi, e mē shum' u,
kūr të gjegjem të këndosh,
e të shoh të hīsh e lezme,
si një fluturzë, te valla;
nkā gjith ëmat e zilisur,
nkā gjith trimat e lëvduar.

δ 16 gjithasājtanith]] gjith asājtanith 18 natës]] nat's

XII

Tremolava una stella nel cielo azzurro,
quando noi tornavamo a casa;
e mia sorella mi prese per mano
e mi disse, con voce soave,
guardando laggiù verso la pianura:
– «Con quanto decoro sorgerà la luna,
tra poco, dalla Valle del melo !
Al suo candore s'inargenteranno
i grandi castagni che nereggiano
là sui ventosi colli
della Dragkora e del Lasi.
Ma quella beata si compiace
di rimirare la propria bellezza
delle limpide correnti,
ché ad un tempo riflessa
la vede per ogni dove.
Così come l'universo, o mio fratello,
quando appare la regina della notte,
abbia lume e gioia
la bianca casa, appena entrerà
la sposa tua, senza toccare la soglia».
– «Ma tu, o Irene, o mia unica sorella,
tu sei il gaudio e lo splendore nostro.
È superba d'averti la mamma
ed anche il padre, ma io più di loro,
quando ti sento cantare
e ti vedo entrar leggiera,
come farfalletta, nella ridda;
da tutte le madri invidiata,
da tutti i giovani lodata.

Bijt e Zotravet të ruajën
e ndër 'ta, tue sherëtuar,
– "Kush dī", thonë, "çili nësh
do t' e kēt te jeta shoqe,
të harronet ndë të dashur !"
Po çë njerit spresha rritet,
se kā mōn të glat përpara
të më shkluhet mbi gjith tjerët».
– «Njoh një e bukur, Mili jim,
çë më mun, si dielli hënxën.
Ti edhe e njeh: Të kālthër sīzit,
e të humbët si edhe dējti;
ār i rrudhuri kështet;
zẽthi i dredhur; shtāti i hollë,
e si qiparisi i dreqt;
zëmbra mẽ se bora e bardhë...
Ō kunatëzë, o Haidhī !
Po të kloft e heshme sīshit
kūr ti plak, përpara vatrës
e shpīs tënde, kē t' e shohësh
lī të tiernjë, ndër kopilet».
– «Rinë, o zëmbër, ti më dën
me kto fjalë... Le të t' puth.
Plot me māll ẽ zẽja ime;
sā-vo dua gjith njerzit mirë;
gjella-vo sā më pëlqen !
U kam bes se, kūr u leva,
i fanmīr, mbi ktë katunt
i rī nj' illëth llamparisëj.
Lisi çë, mbë gas, fitoi
prindi ahierna, ndita ndita,
si vethena, m' u kā rritur;
e nani, mbi rahin tënë,
majën shtīn, çë ng' ujet erës,
përposh diellit e fōr-madhe.

δ 50 shohësh][] shoh'sh 59 llamparisëj.][] llamparis'j. 62 vethena,][] vet'hena,

I figli dei signori ti guardano
e tra loro, sospirando:
– "Chi sa», dicono, "chi di noi
l'avrà compagna al mondo,
a obliarsi nell'amore ?»
Ma a taluno fiorisce la speranza,
ché ha tempo lungo davanti
a rendersi illustre fra gli altri».
– «Conosco una bella, o Milo mio,
che me vince, come il sole vince la luna.
Anche tu la consci: Ceruli gli occhi
e profondi come il mare;
aurea la chioma e crespa;
tremula la voce; esile la persona
e diritta come un cipresso;
il suo cuore poi candido come la neve.
O mia dolce cognata, o Haidhee !
Sia vaga ella sempre agli occhi tuoi
quando vecchia, davanti al focolare
di tua casa, la vedrai
intenta a filare, tra le ancelle».
– «O Irene, o cuor mio, tu m'inebri
con questi tuoi detti… Lascia ch'io ti baci.
L'anima mia è piena d'amore;
quanto amo tutti i viventi,
quanto è bella la vita !
Io credo che, quando io nacqui,
propizio, su questo paese
splendeva un astro nuovo.
La quercia che, nella gioia, piantò
il padre allora, di giorno in giorno
È venuta crescendo col mio essere;
ed ora, sul nostro colle,
erge la cima che non si piega al vento,
sotto il sole alteramente.

mos e djekt shkaptima kūrr,
e ato degë mos i shklieshit
monostrofi ! Kūr, o e mira
ime motër, të martonesh,
nën të madhes ḥë do shtrojëm
tries gjërivet e buruame.
Priftra, zonja, edhe bujarë
vijën gjith te dita jote
të të ndērjën, të t' urojën
dit e vjet e bij të mirë».

δ 66 djekt]] djek't

non la bruci mai il folgore,
né quei rami spezzi giammai
il turbine ! Quando, o buona
sorella mia, prenderai marito
sotto la vasta ombra prepareremo
mense abbondanti al parentado.
Preti, matrone e signori
tutti verranno nel dì della tua festa,
a onorarti e ad augurarti
giorni ed anni e figli buoni».

XIII

Flisj i biri me të jëmën:
– «Mëme, njër ca muaj aprapa,
rroja e rritesha i pa-rē,
si edhe i nokërrth, kūr gjith ditën
me gjitont e vegjij bridhja,
e të ngrisurit çë ngrisej,
mbi glunjët, shumë i lodhët,
të qëllonesha e te gjumi
po ndërrija bridhma e lodhra.
U ndërrua nani vetmeja».
– «Birthi i dashur, çë të streksi
ni, për helm, te hora jonë ?»
– «Mosgjē, mëmëzë; po ndihem
si fitī çë ngë bën pemë».
Mbë gas zonja jerdh' e nisi:
– «U kam bes se ti do dhafnën.
Ndër gjith bijat e bujarvet
dua kërkonj ndo një për tīj.
Janë vasha shum' të mira;
zëmbra jote çilën dēj ?»
– «Streks për Ḥujn çë do e na streks!
Mos kërko ti, zonja mëme,
se ndër tjerat pata fān
vet t' e gjeja nusen time.
Si ndër illzit hënxa e plot,
te një dimbri nat e kalthër,
vajza e Jorgës llamparis…».
Foli e u qet se hīj i jati.
– «E çë bëni ?» – «Rri me nē».
– «Si edhe Rina ng' ē̄ me jū ?»
– «Brënda sot ng' e kemi, o burrë;

δ 1 Flisj‖ Flis'j

XIII

Parlava il figlio con la madre:
– «Mamma, fino a pochi mesi addietro,
io vivea crescendo spensierato,
come da bimbo, allorché tutto il dì
stavo a giocare con i piccoli vicini,
e appena calata la sera,
sui tuoi ginocchi, molto stanco,
mi addormentavo, nel sonno
sognando ognora e chiasso e giochi.
Ora è mutato l'essere mio».
– «Figlio dieltto, e che mai ti accade
da dolertene, ora nel paese nostro?»
– «Nulla, o mamma; ma io mi sento
come una pianta che non produce frutto».
Sorridendo esclamò la signora:
– «Io credo che tu voglia l'alloro.
In tra le figlie dei bugliari
ecco una per te voglio cercare.
Sono fanciulle buone assai;
chi di loro il cuor tuo presceglie ?»
– «Avviene per Dio tutto ciò che avviene!
Tu non cercare, o signora madre,
ché fra le altre ebbi la ventura
di trovare da me stesso la sposa.
Come tra gli astri, piena la luna,
in una cerula notte d'inverno,
la vergine di Jorga rifulge…».
disse e tacque, perché entrava il padre.
– «Or voi che cosa fate ?» – «Sta con noi».
– «Come mai Irene non è qui ?»
– «Oggi non l'avremo dentro, o sposo;

si ti dolle, jerth përtëresha,
ime motër Sarafina,
e m' e deshi njëra sonte,
mos rrie vetëm, se lalbukri
somenat mbi burrat vate.
Kish një vit i mjeri zot
çë ngë dilj; çë kūr i vdiq
(jashta nësh) i ndjemi Rush».
– «Bukur djalë ! Ish gjith i jati».
– «Oce i bẽ, kūr ish i vogël,
siun e lik një rrahadere».
– «Edhe ti kẽ bes kto shusha !
Isht e fteta se djaloshi,
çë kūr vate tek i hoi
e më njohu atë fazezë,
s' pā mẽ drit te gjella e tīj,
mẽ se mẽ kūr xū se ajo
bëj të lënën me disā.
Trimash nip, ai u kish nisur
ment-i-dritëm; e t' akënda
t'e vërreje, aqë i shëndoshëm
ish e i bukur burrërisht.
Ngë kujtone si na u pruar ?
I mëshārm, i verdhë, i rār,
me sīt etheshit të djegur,
sīt e zes e të meruam,
çë i rrëfejën zẽn e kputur.
Buza e tīj ngë qeshi mẽ,
e rrīj dit e dit pā folë,
pā-përzit e ndë kufī.
Jetën la e ngë pati helm,
se u kish shuar te zëmbra e tīj
mālli i gjellës pa-e-çëmuame,
ç' isht e para ndër të mirat.
Mjër e zī kush do një e huajë,

δ 49 disā‖ di-sā

tu eri appena uscito, quando venne la pretessa,
mia sorella Serafina,
e me la volle fino a sera,
per non esser sola, poiché mio cognato
stamane è andato a sovrastare ai villani.
Da già un anno il povero prete
non usciva; dacché gli morì
(lungi da noi la morte !) il povero Giorgio».
– «Bel giovinetto ! Somigliava in tutto il padre».
– «Dicono che gli abbia fatto, quand'era bambino,
il mal'occhio una povera».
– «Anche tu credi a simili stoltezze !
Il vero è che il giovinetto,
dacché andò nell'estranea terra
e conobbe quella trista,
non ebbe più luce nella sua vita;
tanto più quando seppe che essa
folleggiava con molti altri.
Nepote di eroi egli era partito
con pensieri luminosi, ed era una gioia
il vederlo, così robusto
era ed adorno di maschia bellezza.
Non ricordi tu come ci tornò poi ?
Macilento, pallido, cascante,
con gli occhi ardenti per febbre,
gli occhi neri e pieni di mestizia,
che rivelavano un'anima spezzata.
Il suo labbro più non si aperse al sorriso,
ed egli stava interi dì silenzioso,
senza compagnia ed in pensieri.
Lasciò il mondo e non ne ebbe dolore,
ché era spento nel cuore di lui
l'amor della vita preziosa,
che è il più grande fra i beni.
Misero colui che ama una straniera,

e i fanmīr kush katundare
nusen merr çë deshi vet,
o çë prindi i dha me uratën !»
Tue vërrējturith të birin
e të shoqin, sīz'-e-ḥeshme,
jerdh' e nisi e bardha zonjë:
– «Posa i ndodhemi, mbre burrë,
na nani te kta të folë,
u të thom se i vetmi jinë
do martuar, se i jerdhi hera».
– «Ngë kam pasur, gruaza jime,
tjetër rē, ca mot e ktej.
Po kush isht, o Mil, e lumja
çë të rrī ndë trū e ndë zëmbër ?
Flit, o i dashur, të gëzonet
tatëza jit, se dua mē parë
të mbīll sīt ksāj dritje e diellit,
të shoh niprat, çë te jeta
do motrojën embrin tim.
U mbi glunjë do t' i rrinj;
dua dhrosisem t' i ḷimonj
kripthit ari; të m' i puth
bardhë-kuqezit vollī,
të kujtonen prān sā i deshi
tatamadhi, edhe të thēn,
njomur zëmbrjet: "E njohëm !"».
– «Te të zgledhurit, o zot,
pati Mili sī edhe trū,
se ajo vajzë, aqë sā e ḥeshme,
isht e mirë e farje e lart.
Ē, t' e dīsh, Haidhīza e Jorgës.

8 78 Tjetër]] Jetër 82 tatza]] tat'za 85 motrojën]] mosrojën

e beato chi nel natio paese
prende la sposa, che egli stesso volle,
e che, bene augurando, gli diede il padre !
Vezzeggiando con lo sguardo il figlio
e il marito, con occhi sorridenti,
esclamò la candida matrona:
– «Poiché ci siam venuti, o signore,
ora a tal ragionamento,
io vo' dirti che l'unico nostro
chiede la sposa, ché gli è venuta l'ora».
– «Non ho avuto, o mia cara donna,
altro pensiero, da qualche tempo in qua.
Ma chi, o Milo, è la fortunata
che ti sta nella mente e nel cuore ?
Parla, o diletto, perché ne goda
il padre tuo; io voglio, prima
di chiudere gli occhi a questa luce del sole,
vedere i nepoti che nel mondo
eterneranno il nome mio.
Sulle ginocchia vo' che mi crescano;
voglio bearmi a carezzare
i capelli aurei; a baciar loro
le guance candide e vermiglie,
perché pensino poi quanto ebbe ad amarli
il nonno, e dicano,
con tenerezza: – "Lo conoscemmo !"»
– «Nella scelta, o signore,
Milo ebbe occhi e giudizio;
quella vergine quanto bella,
altrettanto è buona e di nobile stirpe.
Ella è, se vuoi saperlo, Haidhee figlia di Jorga».

XIV

Reḥet çë katundin rrethjën
somenat kamnisjën zjarreshit
çë gjith natën llamparisën.
I Shqiptarëvet mbi lipin
mjegullore dita u dī.
Prindi jim, i mjeri plak,
vrërët keq, me sīt mbë trōll,
sherëton e shetiton
shpīs e shpīs çë ng' ish e Gjishit.
Sot te diert, tue qeshur diellit,
Kseravul si vete e hump,
ngë rrīn ujur bujureshat,
rrethur vilrazish të nipra;
as kopilezit, me kënkat,
anangasjën të dëftonet
zonjën hënxë, si një nuse.
Vajza e Jorgës me të jëmën
parkales te klisha e m' t' errme;
të përmista, ndër të zeza,
parkalesjën për Gjërīn
çë te lufta e madhe vdiq.
Dje mbi malin vajta e u hipa
ku, të butit qiell, përhapën
shatorēt e bardha prindrat.
Prapa meje shokt e mī,
vijën gjith me lot ndë sī.
Të plot zëmbërën merije,
plot merije edhe kujtimesh,
vejëm na tue ruajtur vendet
çë të parët embrin patën.
Ō të huaj na jemi ktu !
Mb' at' ān malevet e dējtit
erēt tona fluturojën,
si, dreq diellit, luzmë shqipesh.

δ 4 Shqiptarëvet‖ Çhiptarëvet 25 e mī‖ emī

XIV

Le colline che circondano il paese
questa mattina fumano per i fuochi
che vi brillarono durante la notte.
Sul lutto degli Albanesi
annubilato il dì spuntò.
Il padre mio, povero vecchio,
assai fosco, con gli occhi a terra,
sospirando passeggia
per la casa che non è quella dell'Avo.
Oggi in sulla porta, sorridendo al sole,
che tramonta dietro lo Kseravuli,
non staranno sedute le nobili matrone,
circondate dai loro nepoti;
né le fanciulle, con liete canzoni,
affretteranno a mostrarsi
la signora luna simile a sposa novella.
La figlia di Jorga con la madre,
prega nel tempio tenebroso;
chine a terra, avvolte in gramaglie,
pregano per i consanguinei
morti nella grande battaglia.
Ieri salii sul monte
dove, al cielo mite, spiegarono
i padiglioni bianchi i padri.
Dietro me i miei compagni
tutti venivano con le lacrime agli occhi.
Col cuore pieno di mestizia,
pieno di mestizia e di ricordi,
noi miravamo i luoghi
che primi ebbero nome.
Oh noi qui siamo stranieri !
Di là dai monti, di là dal mare
volano i nostri pensieri,
come gruppo d'aquile fermo al sole.

Vjersh i Milit

O mëma jime, e bukura Shqiprī,
sā ti, o pa-fān, vërtet e bukur jē,
ktu vetëm, tutje ndeje, mënd' e dī,
po ktu, ku të shërtonj, te i huaji dhē.
Si një çë dergjet jasht të bardhës shpī,
ku prindit, i përiturith, u lē,
o mëme, o mëme, jam te dheu litī,
e rronj si zok i varfër pa-folē.

XV

Isht i bukur dheu litī
nkā gjëmori dējt lipījtur,
isht i bukur me nerënxat
e me lulet çë po kā
ndë një verëzë e pa-sosme.
Sīvet tim po ng' isht i shtrejt
si kjo horë, malesh t' egër
rrethur gjith, te Gropa e Shkumbit.
U këtu, te dita e thjellme,
ndë mes vashavet kumbisem
e rrëfienj lëvdīt e prindravet.
Vjen ajo çë zëmbra do,
e gjith tjerat vent i bënjën,
se ndër shoket isht e dashur,
edhe se mē e bukur shumë.
Mua më vū një rrëmp te trūt,
e me gjellë shkrepet fjala
e me jonisī nkā buza.
Vesh më marrjën, se i pëlqen,
vashat bardha edhe ngë tunden.

δ 1 Shqiprī,‖ Shqip'rī,

δ 14 e‖ i 15 edhe‖ e dhe

Verso di Milo

O madre mia, o bella Albania,
quanto tu, o senza fato, sia veramente bella,
solo qui, lungi da te, posso saperlo,
solo qui dove ti sospiro in estranea terra.
Come chi langue fuor della bianca casa
dove al padre nacque desiderato,
o mamma, io sono nella terra latina,
e vivo come uccelletto orfano senza nido.

XV

È bella la terra latina
che il mare risonante lambe,
È bella con gli aranci
e i fiori che sempre la adornano
in eterna primavera.
Ma non è cara agli occhi miei
come questo paese di selvaggi monti
ricinto, nella valle dello Skumbi.
Io qui, nei giorni sereni,
mi siedo tra le vergini
e narro le glorie degli avi.
Viene anche colei che il mio cuore ama
e tutte le altre le cedono il luogo,
ché dalle compagne è amata,
quantunque assai più bella.
Mi mette un raggio nel cervello,
e vivo scintilla il detto
e pieno d'armonia dalle labbra.
Mi ascoltano con diletto
le candide fanciulle e non si muovono.

Të qëndronj u kam te kënkat,
e te moti çë të vinjë
embri jim do jēt i lidhur
me kangjelet çë këndova;
se të bijavet, nd' ān vatrës,
zonjat ëma ja mbësojën,
kūr i keq thārtonet dimbri
e ato tierjën gjith ndë shpī.
Edhe tīj ngë do harrojën,
vajza jime, Zanë e ḥeshme,
çë më holqe jasht errzīs.
Thomse ahierna klisha e madhe,
çë të huajit sot veshtrojën,
ngë do jēt me zografīt.

Or io resterò immortale nei canti,
e nel tempo che verrà
il nome mio sarà legato
alle canzoni che io cantai;
ché alle figlie, presso il focolare
le signore madri le insegneranno,
mentre imperversa l'aspro inverno
ed esse filano tutte in casa.
Né tu sarai lasciata in oblìo,
o mia fanciulla, o vaga Musa,
che mi togliesti dall'oscurità.
Forse allora il tempio maggiore,
che gli stranieri vengono a visitare,
non sarà più con le sue pitture.

XVI

Bobo ç' ëndërr pati vajza,
natën pas të bardhës dit
kūr te shpia m' i hiri këmbë
trimi i dashur për të parëzën !
Keq i zbetur m'u ju duk.
– «Ëm unazën, zonja jime,
ëm unazën, çë të dhash,
përse kam të vete nd' ushtrat
të luftonj për nëndë vjet;
në ng' u prjerrësha martou».
Vate e ajo qëndroi si e nëmur.
Shkuar çë shkuan nëndë vjet,
ndë katunt luftarët jerdhën,
gjith luftarët shok të tījt.
Tek e jëma u nisën e vanë:
– «Zonjë e madhe, bīrthi jit
do të vinjë kūr t' i lāsh
një këmish me lotët e sīvet,
e me zjarrin të ja tērsh,
po me zjarrthin i zëmbrës».
Vanë e gjetën prān të ḥeshmen,
si te dera rrīj tue përitur:
– «Vash, në ti ngë merr një nēsh,
në ngë mērr një nēsh si dhëndërr,
kē të rrīsh e vē gjith-monë.
Ai trim kūj kē aqë māll
çājti besën e u martua.
Nusja kle, në do t' e dīsh,
kle një plak me sīt gërrier
e pā hundë edhe e pā dhëmbë.
Ulq e korbra krushqit klenë,
ulq e korbra çë ni e hān».

δ 7 dhash‖ dash 10 prjerrësha‖ p'rjerrësha 18 lotët‖ lot't 22 pritur‖ p'ritur 25 gjith-monë‖ gjith monë

XVI

Che tristo sogno ebbe la vergine,
la notte dopo il dì felice
quando le entrò a casa fidanzato
l'amor suo per la prima volta !
Molto pallido egli le parve:
– «Dammi l'anello, o mia signora,
dammi l'anello che a te diedi,
ché devo andare alla guerra
a combattere per nove anni;
se non torno, ti marita».
Partì ed essa restò in tristizia.
Trascorsi nove anni,
tornarono in patria i guerrieri,
tutti i guerrieri suoi compagni.
Corsero alla madre di lui:
– «Nobile signora, il figlio tuo
verrà quando gli avrai lavata
una camicia con le lacrime degli occhi,
e col fuoco gliela avrai asciugata,
solo col fuoco del tuo cuore».
Poi andarono a trovare la bella,
che stava alla porta aspettando:
– «O fanciulla, se non prendi uno di noi,
se non prendi uno di noi quale marito,
tu starai vedova per sempre.
Quel giovine che ami tanto
ruppe la fede e prese moglie.
La sposa fu, se vuoi saperlo,
fu una vecchia dagli occhi incavati,
senza naso e senza denti.
Lupi e corvi furono i compari,
i lupi e i corvi che lo divorano».

XVII

Si gjuaj trimi zāll mbë zāll,
nkā një degë qiparizi,
gjith-njī-bashku i tha një zogë:
– «Posa t' rrojëm e t' këndojëm
ngë na lẽ, edhe ti njize
do ndëlgosh sā ẽ lik të vdisetɔ».
– «E si e dī ti, e mjera zogë ?»
– «Nd' ānxë qiellit fluturonj,
e dī shumë, se shoh shumë».
Trimi u zmeks e u pruar mbë shpī.
Mbi ca dit vërte u sëmūr,
e te jeta ng' ish jatrua,
ng' ish mjegjī të m' e shiroj,
se jarruri hera e sprasme.
Thirrën priftin t' e kujtoj:
– «Si më jē ti, birthi jim ?»
– «Ee papas !... Mẽ atej se ktej...»
– «Po kā sprënxë kush ẽ gjāll».
– «Ti kē liq; nkā varri vetëm
jik ajo. Po ndienj se gjella
mua më lẽ, si dallandishja
la folēn... Ajlimano !
Bes ng' e kisha, zoti jim,
se kshtu djalëth u kish vdisja.
– «Fān i burravet ẽ kī,
posa jemi na mbi dheun
udhëtarë. Ẽ qielli, o bīr,
vendi jinëth i vërtet.
Ktu ç' i kemi ? Helm e lotɔ.
– «Gjaku, o plak, t'u ftoh te thekat;
ti jē lodhët e do prëhet

δ 14 jarruri]] j' arruri

XVII

Mentre il giovine cacciava di lido in lido,
dal ramo di cipresso
d'improvviso gli disse un augello:
– «Poiché vivere e cantare
non ci lasci, anche tu presto
apprenderai quanto sia dura la morte».
– «E come lo sai tu, povero uccello ?»
– «Vicino al cielo io volo,
e so molto perché molto io vedo».
Il giovine impaurito tornò a casa.
dopo pochi giorni veramente ammalossi,
e nel mondo non v'era medico,
non v'era medicina che potesse guarirlo,
poiché l'avea raggiunto l'ora estrema.
Chiamarono il prete per assisterlo:
– «Come stai tu, o figlio mio ?»
– «Eh papas!... Più di là che di qua».
– «Ma chi vive ha ognora speranza».
– «Tu dici bene; sol dai sepolcri
ella fugge. Ma io sento che la vita
mi abbandona, come la rondinella
abbandonò il suo nido... Ahimè !
Non credevo, signor mio,
di dover morire così giovane».
– «È fato degli uomini questo,
poiché siamo sulla terra
viaggiatori. È il cielo, o figlio,
la nostra vera patria.
Che cosa abbiamo qui ? Dolore e pianto».
– «Il sangue, o vecchio,è freddo nelle tue vene,
sei stanco e vuole riposo

kurmi jit; andaj pa-drē
zgarth e sheh nën këmbës varrin.
si hërnār çë vajt i lipset,
ti më shuhe dalë e dalëth,
se m' e bëre dritën tënde».
– «Po edhe ti, si nj' ill i dhezur,
si një gūr i pa-çëmuam
te kurora e Perëndīs,
do shkëlqesh te jatra jet,
ku ngë klahet as duronet;
se ẽ zjarr vdekja ku thjellonet
ari e merr sillën çë kā.
U të thom se zẽm e rrojëm
si mbëllijëm sīzit diellit».
I meruamith me një gas,
me një gas i veshkurith,
ai trim, si një pa-besëm,
jerdh' e nisi: – «Kush e dī !»
Zẽj e ngrisej. Nkā dritsorja
hīj një drit margharitare,
se ndër nat e dit ish hera.
– «Ajli ! Dielli perëndoi
e ng' e pāsh... U qet e buzën
mẽ ngë shqepi, njër çë moti,
si gūr lumi, e la i pa-tundur.
Rā këmbora e madhe e klishës
trī hër' tre te nata e humbët,
e tek ajri i shkundur erësh
si rëkim ai zān u buar.
Një qen lehëj ndë mes udhës.

δ 50 dritsorja] drit'sorja

il tuo corpo; però senza terrore
vedi spalancata la tomba davanti.
Come lucerna cui l'olio vien meno,
tu langui a poco a poco,
perché hai mandato il tuo lume».
– «Ma anche tu, come un astro ardente,
come pietra preziosa
nel serto del Signore,
rifulgerai nell'altra vita,
là dove non si piange, né si soffre.
È fuoco la morte ove si purifica
l'oro e assume il suo fulgore.
Or ti dico che incomincia la nostra vita
appena chiudiamo gli occhi al sole».
Con un mesto sorriso,
con un sorriso appassito,
quel giovine, come senza fede,
esclamò: – «Chi lo sa !»
Imbruniva. Dalla finestra
penetrava una luce gemmea,
ché l'ora pendea tra il dì e la notte.
– «Ahimè, il sole è tramontato,
e non l'ho veduto!...». Tacque, e il labbro
più non aperse, finché il tempo,
come pietra di fiume, lo lasciò immobile.
Risuonò la campana grande del tempio
tre volte tre nella notte fonda,
e per l'aere scosso dai venti,
come singulto, si perdette quel suono.
Un cane latrava in mezzo alla via.

XVIII

Mbi trī dit, te klisha e madhe,
gjetën vajzën mbi atë varr
te ku prëhej mālli i sāj.
Te ajo shpī fān-zezë e Jorgës,
ku mbi strehën për gjith natën
kish gjëkuar i bushtri gjon,
muarn e e qellën për vajtimet,
e te shtrati i virgjërīs
e kumbisën. Lidhur duarzit,
ndë mes lulevet, ç' e gjallë
deshi aqë sā gjith stolīt,
glat mbi shtrat, si një çë flēj,
fitīr dilli, rrīj Haidhia,
me një gas te fixha i piksur.
Ār të tjerrë kript i ḥidhej
për ndë krahvet, mbi të njomin
gjīth, ahēr pa laftarī.
ghodhë ghodhë rridhjën gjindet
sā t' e shihjën. Zëmbra e gjithve
ish ndë lip, se u kishën shuar,
për gjith-monë, sīt e bukur,
çë t' afruam la hera e zezë,
nkā harē dëḷīre shkrepej.
Ndër të zeza, lesh e shpleksur,
zonja e jëmë, zëmbr e kputur,
pā një lot te sīt pa-bes,
zū vajtimin: – «Limanò !
Kshtu nkā klisha ti m' u prore
e pā dhafnë, o bījza jime ?
Më zilisi Perëndia,

δ 7 muarn]] muar'n 15 ḥidhej]] ḥidhej; 21 gjith-monë]] gjith monë
25 zëmbr]] zëmb'r

XVIII

Tre giorni dopo, nel maggior tempio,
trovarono la vergine su quel sepolcro
dove era chiuso l'amor suo.
Nella casa sventurata di Jorga,
sul cui tetto, per un'intera notte,
avea singhiozzato il gufo,
la portarono per i canti funebri,
e sul letto verginale,
la posarono. Incrociate le mani,
in mezzo ai fiori, che viva
preferì a tutti gli ornamenti,
stesa sul letto, come dormente,
cerea, stava Haidhee,
con un sorriso gelido in faccia.
Oro filato le piovea la chioma,
per gli omeri, sul morbido
seno, allora senza un palpito.
Accorrea la gente a torme
per vederla. Il cuore di tutti
era in lutto, ché si erano spenti
per sempre gli occhi belli,
che socchiusi lasciò l'ora funesta,
donde già il gaudio puro scintillava.
In gramaglie, con trecce sparse,
la madre, dal cuore infranto,
senza lacrime gli occhi increduli,
incominciò la nenia: – «Limanò !
Così tu mi torni dal tempio,
priva d'alloro, o figlia mia ?
Mi invidiò Iddio,

e më mbjodhi tīj, o lule,
lule e vetmez' e kurorës;
e më shuajti tīj, o drit;
drit e bardhë e sīvet tim.
Më nani s' kam të të shoh,
mbë t' haraksur, për ndë shpīs,
t' e gëzosh me t' ëmblën jōnë,
si me drit e rē edhe dielli.
O Haidhīzë, o zëmbra jime,
te kjo shpī ku kishe ḥē,
si fëllëzë maje gurit,
si lē mëmën ? Si më lē
ktu, si kāllm ndë fush i fīllm ?
Te të krëmtet, kūr të shkojën
ktej kopilet të stolisme,
më te dera e t' zezës shpī
ngë qëndrojën të t' thërresjën;
po kujtimi i vashrīs tënde
shpejt atire e spavur sīshit,
do përtrihet tek ato.
«T' ish me nē», ka thën, "e mira,
çë për pak na patëm shoke !
Ni gëzon me bukurīn
tjera valla shpīrti i sāj».
Kshtu do thēn, e nkā dritsorja,
ku jam u, t' i hā me sī,
prapa vitrevet, do përiren,
e më falen ndë merī !
Të kërkonj në mestr atire,
të kërkonj e ngë të gjēnj.
Edhe pak thjellonet qielli;
frimës vakt e paraverës
loset bora e shkrehjën lulet,
bredhjën vallat, bien flojerët,

δ 55 dritsorja,‖ drit'sorja, 57 priren,‖ p'riren, 60 gjēnj‖ gjeeni

e colse te, o fiore,
unico fiore della mia ghirlanda,
e mi spense te, o luce
candida luce degli occhi miei.
Or non più ti vedrò,
al mattino aggirarti per la casa
ad allietarla con la voce soave,
come il sole allieta di luce novella!
O Haidhee, o mio cuore,
in questa casa dove avevi decoro,
quale pernice in cima alla rupe,
come lasciasti la mamma? Come mi hai lasciata
qui, quale canna solitaria in una pianura?
Nei dì festivi, quando passeranno
di qui le fanciulle adornate,
non più alla porta della trista mia casa
a chiamarti si fermeranno;
ma il ricordo della tua giovinezza,
sparita di un subito ai loro occhi,
si rinnoverà in esse.
"Fosse con noi", diranno, "quella buona
che per poco tempo fu nostra compagna !
Ora allieta colla sua beltà
altre ridde l'anima di lei".
Così diranno, e alla finestra,
dove sto io a mangiarle con gli occhi,
dietro i vetri, si volgeranno
e mi salutano mestamente !
Ti cerco in mezzo a loro,
ti cerco e non ti trovo.
Fra poco diverrà limpido il cielo;
all'aura tiepida di primavera
si scioglie la neve e sbucciano i fiori,
danzano i cori, suonano i flauti,

ajri kënkazish qëmbon;
po ti, o bijë, ngë sheh gjẽ,
po ti vetëm gjẽ ngë gjegje.
Çë të lipsej te kjo jet ?
Mos ngë kishe ti stolī ?
s' kishe t'bardhën rrëmp e hënxës,
